



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

(Miratuar me vendimin nr. 121, datë 08.06.2018 të AMA-s)

## UDHËZIM

### **PËR FORMAT DHE KATEGORITË E PROGRAMEVE PËR REGJISTRIM DHE ARKIVIM NGA OFRUESIT E SHËRBIMIT MEDIATIK AUDIOVIZIV (OSHMA)**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurat dhe rregullat që duhet të ndiqen për regjistrimin dhe arkivimin e programeve të transmetuara nga ofruesit e shërbimit mediatic audioviziv (OSHMA).

#### **Neni 2 Baza ligjore dhe fusha e veprimit**

1. Ky udhëzim hartohet në bazë dhe për zbatim të:
  - ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
  - ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”;
  - ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”;
  - ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
  - ligji nr. 8096, datë 21.03.1996 “Për kinematografinë”, i ndryshuar.
2. Dispozitat e këtij udhëzimi do të zbatohen për të gjithë ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 3 Përkufizime**

Termet e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ofrues shërbimi mediatik audioviziv (OSHMA)” është personi fizik ose juridik që ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv dhe që vendos mënyrën e organizimit të saj.
2. “Përgjegjësi editoriale” është ushtrimi i kontrollit efektiv mbi përzgjedhjen e programeve dhe organizimin e tyre në:
  - a) një listë dhe orar, në rastin e shërbimeve të transmetimit të drejtpërdrejtë audioviziv;
  - b) një katalog, në rastin e shërbimeve të programit audioviziv, sipas kërkesës.
3. “Prodhime të pavarura” janë aktivitete të prodhimit të veprave audiovizive, të cilat plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:
  - a) kur nuk janë të kontrolluara ose të lidhura me transmetues me licencë ose me autorizim për transmetimin;
  - b) kur për një periudhë prej tre vitesh, të paktën 90 për qind e këtyre prodhimeve nuk janë të destinuara për një transmetues të vetëm.
4. “Prodhues i pavarur” është personi fizik a juridik, që nuk është i përfshirë në prodhimin e shërbimeve mediatike audiovizive, i cili prodhon filma, programe reklamash, transmetime ose programe me natyrë individuale audiovizive.
5. “Program radio” është tërësia e mesazheve audio që përbëjnë një element individual brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, forma dhe përmbajtja e të cilit janë të krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit radio.
6. “Program televiziv” është tërësia e imazheve lëvizëse, me ose pa zë, që përbëjnë një element individual brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, forma dhe përmbajtja e të cilit janë të krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit televiziv. Shembujt e programeve përfshijnë filma, ngjarje sportive, komedi, dokumentarë, programe për fëmijë dhe drama origjinale.

Termat e tjerë në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

#### **Neni 4**

#### **Detyrimet e OSHMA-ve**

1. OSHMA duhet të mbajë katalogun e programeve dhe të regjistrojë çdo emision, reklamë dhe programe të tjera të transmetuara prej tij, në përputhje me licencën dhe/ose autorizimin.
2. OSHMA duhet të regjistrojë dhe arkivojë, për një periudhë 6 (gjashtë) vjet për transmetuesit audio dhe 1 (një) vit për transmetuesit audiovizivë, programet e mëposhtme:
  - a) Programet në gjuhën shqipe që lidhen me veprimtaritë kombëtare me natyrë muzikore – festivale, koncerte, shfaqje premierë të TOB, Teatrit Kombëtar, Teatrit të Estradës dhe të tjera të ngjashme;
  - b) Programet në gjuhën shqipe që lidhen me veprimtaritë kombëtare me natyrë sportive – ndeshje të ekipeve kombëtare të Shqipërisë, turne kombëtare dhe ndërkombëtare dhe të tjera të ngjashme;
  - c) Lajme dhe dokumentarë të prodhuar nga vetë OSHMA-të.
3. Programet që transmetohen nga OSHMA-të, të cilat nuk kanë vlera arkivore duhet të ruhen për një periudhë 3 (tre) mujore nga dita e transmetimit.

4. OSHMA-ja duhet të garantojë që regjistrimet e transmetimeve të programeve të tij të kenë cilësi të mirë, me zë dhe figurë.
5. OSHMA-ja duhet të marrë masat për mbrojtjen e materialeve të regjistruara, nga agjentët atmosferikë si dhe të marrë masat për ruajtjen e këtyre materialeve prej marrjes nga persona të paautorizuar dhe nga dëmtimet e mundshme apo humbjet.
6. Mbajtja e regjistrimeve të programeve të transmetuara nga OSHMA-ja, nuk duhet të shkelë kërkesat e ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, për arkivat dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.
7. Pavarësisht pikave 1 deri 6 të këtij neni, AMA mund të realizojë me mjetet e veta regjistrimin dhe arkivimin e programeve të transmetuara prej OSHMA-së dhe ka detyrimin të administrojë këto programe, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të.

### **Neni 5**

#### **Format dhe mënyrat e mbajtjes së regjistrimeve/katalogut të programeve nga OSHMA-të**

1. OSHMA-ja, me mjetet dhe pajisjet e tij teknike duhet të regjistrojë çdo transmetim apo program të ofruar prej tij si dhe duhet të mbajë katalogun e programeve, në format elektronik ose të printuar.
2. Katalogu i programeve së OSHM audioviziv, duhet të ketë të dhënat e mëposhtme:
  - a) datën e transmetimit;
  - b) kohën e transmetimit;
  - c) kohëzgjatjen e përgjithshme;
  - d) titullin e përmbajtjes së transmetuar;
  - e) transmetimin premierë;
  - f) llojin e programit audioviziv;
  - g) llojin e prodhimit të programit audioviziv (prodhim i vetë ose program i të tretëve);
  - h) vendin e prodhimit (kur bëhet fjalë për programin e huaj);
  - i) emrin e prodhuesit (nëse programi është i krijuar nga prodhues i pavarur).
3. Katalogu i programeve së OSHM audio duhet të ketë të dhënat e mëposhtme:
  - a) datën e transmetimit;
  - b) kohën e transmetimit;
  - c) kohëzgjatjen e përgjithshme;
  - d) titullin e përmbajtjes së transmetuar;
  - e) llojin e programit audio;
  - f) llojin e prodhimit të programit audio (prodhim i vetë ose program i të tretëve);
  - g) vendin e prodhimit (kur bëhet fjalë për programin e huaj);
  - h) emrin e prodhuesit (nëse programi është i krijuar nga prodhues i pavarur).

### **Neni 6**

#### **Cilësia dhe mënyra e mbajtjes së regjistrimeve**

1. OSHMA-të kanë detyrim që të regjistrojnë programin e tyre pa ndërhyrë në përmbajtjen e tij. Programi i regjistruar duhet të jetë i njëjtë me programin e transmetuar tek publiku.

2. Regjistrimi i programit (sinjalit dalës) bëhet çdo ditë, respektivisht duke filluar në ora 00:00 dhe përfundon në ora 24:00.
3. OSHMA duhet të regjistrojë programet e transmetuara në një prej këtyre formateve: MP4 (H.264 AVC), AVI, ASF, WMF, WMV.
4. Regjistrimi duhet të ketë cilësi të mirë zëri dhe figurë.

### **Neni 7**

#### **Detyrimi për depozitimin e regjistrimeve**

OSHMA-të, pas paraqitjes së kërkesës së AMA-s për depozitimin e regjistrimeve të mbajtura dhe katalogut përkatës në zbatim të këtij udhëzimi, kanë detyrim të depozitojnë materialet përkatëse brenda afateve të kërkuara nga AMA.

### **Neni 8**

#### **Gjobat**

1. Mosrespektimi i dispozitave të këtij udhëzimi mbi afatin e ruajtjes së regjistrimit të transmetimeve përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 40 000 lekë deri në 400 000 lekë.
2. Gjoha vendoset nga inspektorët ose AMA, me nismën e tyre ose pas ankimit të subjekteve të interesuara.
3. Kundër vendimit të dënimit me gjobë mund të bëhet ankim në AMA brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni. AMA merr vendim brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit.
4. Kundër vendimit të AMA-s, subjekti ka të drejtë të bëjë ankim në përputhje me ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.
5. Gjoha është titull ekzekutiv që ekzekutohet nga shërbimi përmbarimor.

### **Neni 9**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Autoriteti i Mediave Audiovizive.

### **Neni 10**

#### **Publikimi**

Ky udhëzim publikohet nga AMA në faqen zyrtare të internetit [www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al).